



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.253/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën e datës 02.04.2021 me numër A.nr.253/2021, e regjistruar me datë 06.04.2021, e parashtruar përmes postës së Kosovës me numër R 1549561, nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja me adresë rruga “Rexhep Luci”, H-29 me nr.8 në Komunë të Prishtinës, për ankuesin kundër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në çështjen juridike “Kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.253/2021 e datës 06.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET në fuqi Vendimi Nr. 02/4263 i datës 29.07.2020 për pagesën e njëhershme të një page të fundit, për ankuesin me rastin e pensionimit.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në pozitë ‘Zyrtar për Politika Turistike’, në Departamentin e Industrisë, sipas ndryshim plotësimit të Akt emërimit të datës 04.12.2014, me datë 28.07.2020 Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka nxjerre Vendimin Nr.4224, për përfundimin e marrëdhënies së punës nga data 15.08.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, dhe me datë 29.07.2020 ka nxjerrë vendimin me numër 02/4263 për pagesën e njëhershme të një page të fundit, për shkak të pensionimit në vlerën e pagës së fundit, i cili me datë 31.08.2020 i është bërë pagesa sipas pasqyrës së bankës, Pro Credit Bank.

Ankuesi me datë 21.12.2020 ka parashtruar kërkesë në Departamentin Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për mos pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit tri pagave jubilarë dhe shujtën sipas marrëveshjes së përgjithshme kolektive, i cili me datës 10.03.2021 ka pranuar përgjigje në kërkesën e tij. I pa kënaqur me përgjigjen e datës 10.03.2021, ka parashtruar ankesë me

datë 02.04.2021 përmes postës së Kosovës me numër R 1549561 nga përfaqësuesja e autorizuar avokates në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 06.04.2021 me numër A.nr.253/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Më datë 22.04.2021 Ministria respektivisht organi i punësimit ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, për marrjen e vendimit merititor ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit me shkresat e bashkangjitura, ankesa A.nr.253/2021 me numër protokollit 1613/2021 të datës 02.04.2021 e regjistruar me datë 06.04.2021, e parashtruar përmes postës së Kosovës me numër R 1549561, nga përfaqësuesja e autorizuar avokates Autorizimi i datës 12.03.2021; Përgjigje e datës 10.03.2021; Vendimi Nr.4224 i datës 28.07.2020; Vendim Nr.4263 i datës 29.07.2020; Certifikatë nr.15 e datës 22.06.2020; Vërtetim i datës 13.09.2011; Vërtetim Nr.578 i datës 30.07.2020; Vërtetim nr.588 i datës 30.07.2020; Vërtetim Nr.22635/2018 i datës 26.10.2018; Vërtetim nr. 13648/21 i datës 25.02.2021; Certifikatë Nr.21343/20 i datës 18.06.2020; Vërtetim i marrëdhënies së punës i datës 25.03.2021; Raport mjekësor i datës 03.06.2015; Ndryshim plotësim i Akte emërimit i datës 04.12.2014; Përshkrim i detyrave të punës i datës 04.12.2014; Akte emërim i datës 30.01.2012; përshkrim i detyrave të punës i datës 30.01.2012; Pasqyra e llogaris bankare të ankuesit ne data 01.05.2020 deri më datë 30.11.2020; Dëftesë e postës së Kosovës e datës 21.12.2020; Kërkesë e datës 14.12.2020; Pliko postare e datës 02.04.2021 me numër R1549561; Kërkesë për përgjigje ne ankesë e datës 16.04.2021 nga KPMSHCK; **Përgjigje në ankesë e datës 22.04.2021 me numër protokollit 1947/2021 nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, me shkresat e lëndës:** Përgjigje e datës 21.04.2021 nr. 3141; E-maili i datës 22.07.2020; Pasqyra nga pagesa retroaktive e datës 31.08.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datë 02.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me numër R1549561 nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja znj e regjistruar me datë 06.04.2021 me numër A.nr.253/2021, pasi që me datë 10.03.2021 ka pranuar Përgjigjen në Kërkesën e datës 21.12.2020 nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me pretendime ankimore për mos pagesën e tri pagave jubilarë, tri pagave me rastin e pensionimit dhe shujtën sipas marrëveshjes së përgjithshme kolektive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi pasi që ka pranuar përgjigjen e datës 10.03.2021 nga Departamenti Ligjor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me datë 02.04.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me numër R 1549561 nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja znj e që sipas vlerësimit të kolegjit është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 127 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”**, që në rastin konkret ankuesi në përgjigjen nr.2094 të datës 10.03.2021 është njoftuar nga Departamenti Ligjor mbi bazën ligjore, lidhur me atë se nuk është kompetent për vendosjen e çështjes juridike sipas

kërkesës për pagesën e pagave jubilarë, me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesit i ka filluar ti rrjedh afati për ankimim në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë kur ankuesit i është bërë pagesa e një page mujore të njëhershme në vlerë të pagës së fundit, sipas Vendimit nr.02/4263 të datës 29.07.2020, ku me datë 31.08.2020 ankuesit i është bërë pagesa me rastin e pensionimit, sipas gjendjes së llogarisë së bankës së Pro Credit Bankës, e cila provë është bashkangjitur në dokumentacionin e ankuesit, mbi këtë bazë është konstatuar se ankuesi në pretendimet ankimore deklaron se i është bërë pagesa vetëm e një page përcjellëse me rastin e pensionimit.

Bazuar në dispozitën ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ku përcaktohet se: **" 3. Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil"**, që në rastin konkret Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020 bazuar në Aktgjykimin GJK-KO203/19-AKV i Gjykatës Kushtetuese, dhe e drejta e ankimit të ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, ka qenë momenti kur ankuesit i është bërë pagesa e një page të fundit me rastin e pensionimit, me datë 31.08.2020 në llogarinë bankare, dhe afati 30 ditësh për ankimim ka qenë pas datës 31.08.2020, kur ankuesi ka kuptuar se nuk i është bërë pagesa edhe për tri pagat jubilarë dhe tri pagave me rastin e pensionimit dhe pretendimet e tjera sipas marrëveshjes së përgjithshme kolektive.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi pasi ka pranuar një page mujore të njëhershme me datë 31.08.2020 në vlerë të pagës së fundit, me rastin e pensionimi, sipas Vendimit nr.02/4263 të datës 29.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, ka parashtruar kërkesën e datës 14.12.2020 përmes postës së Kosovës, e vulosur me datë 21.12.2020 me numër serik 2004202062464 të dëftesës për pranimin e dërgesës, tek Departamenti Ligjor i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse pas pranimit të Përgjigjes së datës 10.03.2021, me datë 02.04.2021 ankesën e ka adresuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me numër R1549561, nga përfaqësuesja e autorizuar avokatja që është jashtë afatit ligjor, të përcaktuar në nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku thuhet se: **"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"**, që në rastin konkret ankesa e datës 02.04.2021 e ankuesit është adresuar jashtë afatit ligjor edhe nga momenti kur nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e datës 21.12.2020 mbi bazën e dispozitave të cekur si më lartë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.4224 i datës 28.07.2020, me rastin e pensionimit dhe Vendimi Nr. 02/4263 i datës 29.07.2020 për pagesën e njëhershme të një page të fundit, për ankuesin me rastin e pensionimit, ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 60 paragrafit 1 nën paragrafin 1.3 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik dhe dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku përcakton se: **" 1. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur:..... 1.3. plotësohet moshja për pensionim;..... 2. Moshja e pensionimit rregullohet me Ligjin e punës"**, duke vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.253/2021, datë 12.05.2021.

Zyle Millaku **GOJNOVCI**

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësueses së autorizuar Avokates (për ankuesin);
- Sekretarit Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë,
- Udheheqesit të Personelit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

